




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit
Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra Ligjore - Pravna Kancelarija - Legal Office



REFERENCË:	4452/2-2023
DATE:	05.07.2023
PËR/ZA/TO:	Klit Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor/MFPT
CC:	Arben Krasniqi, Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm/ZKM; Novitet Nezaj, Drejtor i Departamentit të së Drejtës së BE-së/ZKM; Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore/ZKM; Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm/MFPT; Drinas Zeqiraj, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit/MFPT
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arben Krasniqi, zv. Sekretar i Përgjithshëm / Zyra e Kryeministrit; Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore / Zyra e Kryeministrit.
NGA/OD/FROM:	Labinote Kashtanjeva, zv. Udhëheqëse e Divizionit për Çështje Ligjore të BE-së / Zyra Ligjore / Zyra e Kryeministrit. Për: [Signature]
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shkresa përcjellëse për Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

I nderuar z. Shala,

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Rregulloren nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenin 8 par 2.16 si dhe nenin 12 par 1.1 të Rregullores (ZKM) Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, ju përcjellim Opinionin Ligjor të Përputhshmërisë me *acquis* të BE-së për Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada Government
Zyra e Kryeministrit
Kancelarija Premijera – Office of the Prime Minister
Zyra Ligjore – Pravna Kancelarija – Legal Office

OPINIONI LIGJOR I PËRPUTHSHMËRISË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

05.07.2023

Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me datë 4 korrik 2023, bazuar në nenin 7, nën paragrafin 1.2 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe nenit 13, paragrafit 5 të Rregullores Nr. 13/2023 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, si dhe në pajtim me nenin 12, paragrafin 3 dhe 4, nën paragrafin 4.19 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 për Fushat e Përgjegjësisë të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, ka dorëzuar për shqyrtim në Divizionin e të Drejtës së BE-së, në Zyrën e Kryeministrit “*Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti*”.¹

1. SUBJEKTI

Opinion Ligjor për Përputhshmërinë e “Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti”, me *acquis* të BE-së.

¹ Kërkesa për Opinion Ligjor të Përputhshmërisë është kërkuar të procedohet me urgjencë me datë 4 korrik 2023.

2. DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA

Në kërkesën e Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me *acquis* të BE-së, janë dërguar këto dokumente:

- Drafti përfundimtar i *Projektligjit* në 3 gjuhë (versioni i gjuhës shqipe, angleze, dhe asaj serbe);
- Deklarata e Përputhshmërisë;
- Memorandumi Shpjegues.

3. PREAMBULA

Në pajtim me nenin 7, paragrafin 3 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nenit 3, nënparagrafit 1.3, nenit 13, paragrafi 6, si dhe nenit 21, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenit 30, paragrafit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Divizioni i së Drejtës së BE-së, së Zyrës së Kryeministrit, bazuar në fushëveprimin e kompetencave të tij, me datë 5 korrik 2023, lëshon këtë:

4. OPINION LIGJOR PËR PËRPUTHSHMËRINË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË
Kërkesa për **Opinion Ligjor** me *acquis* të BE-së është dërguar në dosje fizike dhe elektronike me datën 4 korrik 2023.

5. HYRJE

Qëllimi i këtij *Projektligji* është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në zbatim të Aktgjykimit KO190/19 të Gjykatës Kushtetuese duke rregulluar dispozitat ligjore të cilat janë në mos-përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.² Ky *Projektligj* gjithsej përmban 9 nene.

² Neni 1 i *Projektligjit*.

6. PËRMBLEDHJA E AKTEVE TË BE-SË QË RREGULLOJNË FUSHËN E PROJEKT-AKTIT NORMATIV

Korniza e të drejtave të pensionimit është e përcaktuar me acquis të BE-së. Rrjedhimisht, kjo fushë është e rregulluar me legjislacionin primar dhe sekondar të BE-së.

Në nivel të legjislacionit primar, **Traktati mbi Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFBE)**³, **Titulli IV – Lëvizja e Lirë e Personave, Shërbimeve dhe Kapitaleve, Kreu 1, neni 48**, përcakton:

“Parlamenti Evropian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legislative, miratojnë masa në fushën e sigurimeve shoqërore që janë të nevojshme për të siguruar lirinë e lëvizjes për punonjësit. Për këtë qëllim, ata marrin masa për të siguruar për punonjësit migrues të punësuar, të vetëpunësuar si dhe për personat që i kanë këta në varësi:

- (a) agregimin, me qëllim fitimin dhe mbajtjen e të drejtës për përfitim dhe llogaritjen e vlerës së përfitimit, e të gjitha periudhave që merren në konsideratë sipas ligjeve të disa vendeve;*
- (b) pagesën e përfitimeve personave që kanë vendbanimin në territoret e Shteteve Anëtare.*

Kur një anëtar i Këshillit deklaron se një projektakt legjislativ i përmendur në nënparagrafin e parë do të prekte aspekte të rëndësishme të sistemit të tij të sigurimeve shoqërore, përfshirë fushën e veprimit ose strukturën financiare të kostos, ose do të prete ekuilibrin financiar të këtij sistemi, ai mund të kërkojë që çështja t’i përcillet Këshillit Evropian. Në këtë rast, procedura e zakonshme legislative pezullohet. Pas diskutimit, brenda katër muajve prej këtij pezullimi, Këshilli Evropian ose:

- (a) ia rikalon çështjen Këshillit, i cili i jep fund pezullimit të procedurës së zakonshme legislative; ose*
- (b) nuk bën asnjë veprim ose i kërkon Komisionit të paraqesë një propozim të ri. Në këtë rast, konsiderohet se akti i propozuar më parë nuk është miratuar.”*

³ E qasshme përmes: Versioni i Konsoliduar i Traktotit

Në kuadër të legjislacionit sekondar, instrumentet kyçe legjislative që burojnë nga neni 48 i TFBE-së, janë **Rregullorja 883/2004** e datës 29 prill 2004 për koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore⁴ si dhe **Rregullorja Zbatuese 987/2009** e datës 16 shtator 2009 për vendosjen e procedurës për zbatimin e Rregullores 883/2004.⁵ Për më shumë, në kuadër të legjislacionit sekondar sa i përket të drejtave për sigurimet shoqërore siç janë pensionet, është edhe **Rregullorja 1231/2010** e datës 24 nëntor 2010 e cila zgjeron fushëveprimin e Rregulloreve 883/2004 dhe 987/2004 sa i përket koordinimit të sigurimeve shoqërore të BE-së për shtetasit e vendeve jo-anëtare (shtetasit e vendeve të treta) që banojnë ligjërisht në BE.⁶ Anëtarët e familjes dhe të mbijetuarit e tyre po ashtu mbulohen nga kjo Rregullore nëse janë në BE. Në kuadër të pensioneve, Rregullorja e koordinimit të BE-së mbulon pensionet e pleqërisë, pensionet e të mbijetuarve dhe pensionet e invaliditetit. Rregullat e koordinimit të BE-së përcaktojnë katër parime të përgjithshme, përkatësisht trajtimin e barabartë, grumbullimin e periudhave, asimilimin e fakteve dhe eksportueshmërinë. Konform këtyre parimeve, eksportimi i përfitimeve është thelbësor për mbrojtjen e të drejtave të fituara nga sigurimet shoqërore. Rolin qendror në përmbushjen e këtij parimi të përgjithshëm e luan neni 7 i Rregullores 883/2004, i cili heq dorë nga rregullat e qëndrimit (rezident) për shumicën e përfitimeve të sigurimeve shoqërore që përfshihen në objektin dhe fushëveprimin e Rregullores. Për më shumë, në kuadër të legjislacionit sekondar në fushën e pensioneve, është edhe **Direktiva e Këshillit 98/49/KE** e datës 29 qershor 1998 mbi ruajtjen e të drejtave të pensionit suplementar të personave të punësuar dhe të vetëpunësuar që lëvizin brenda Komunitetit.⁷ Synimi i kësaj Direktive është të mbrojë të drejtat e anëtarëve të skemave të pensioneve suplementare të cilët lëvizin nga një shtet anëtar në tjetrin, duke kontribuar kështu në heqjen e pengesave për lëvizjen e lirë të personave të punësuar dhe të vetëpunësuar brenda Komunitetit. Një mbrojtje e tillë i referohet të drejtave të pensionit si në skemat e pensionit suplementar vullnetar ashtu edhe në atë të detyrueshëm.

⁴ E qasshme përmes: Rregullorja 883/2004

⁵ E qasshme përmes: Rregullorja Zbatuese 987/2009

⁶ E qasshme përmes: Rregullorja 1231/2010

⁷ E qasshme përmes: Direktiva 98/49/KE

7. PËRSHKRIMI DHE VLERËSIMI I DOKUMENTEVE TË DËRGUARA ME LEGJISLACIONIN E PROPOZUAR NGA INSTITUCIONI I LINJËS

Nga aspekti përmbajtësor

Dispozitat e këtij *Projektligji* ndryshojnë dhe plotësojnë ligjin bazik Ligjin Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në zbatim të Aktgjykimit KO190/19 të Gjykatës Kushtetuese duke rregulluar dispozitat ligjore të cilat janë në mos-përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Nga aspekti teknik

Dokumentacioni shoqëruar është pjesërisht në përputhje Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative dhe me Udhëzimet Praktike për Përafrimin e Legjislacionit të Republikës së Kosovës me Legjislacionin e BE-së. Përgjatë analizës paraprake të Deklaratës së Përputhshmërisë (DeP), vërejmë se nuk janë listuar burimet primare dhe sekondare të *acquis* në fushën e skemave pensionale. Rekomandohet që Institucioni përgjegjës të plotësojë Deklaratën e Përputhshmërisë, konform pikës 6 të këtij **Opinion**.

8. OPINIONI I PËRPUTHSHMËRISË

Ky **Opinion i Përputhshmërisë** është bazuar në përmbajtjen e draftit të projekt-aktit. Përgjegjësia e Divizionit për të Drejtën e BE-së në ZL/ZKM vihet në dukje me opinionin e saj, ndërsa institucioni propozues, është përgjegjës të plotësojë Deklaratën e Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelat e Përputhshmërisë (TeP), atëherë kur projekt-akti ndërlihet me transpozim të *acquis* së BE-së. Institucionet e linjës janë përgjegjëse për politikën që ato bëjnë dhe për shkallën e harmonizimit me *acquis* të BE-së. Prandaj, periudhat paraprake nga transpozimi i pjesërishtëm deri në transpozim të plotë janë përgjegjësi e organit propozues të projekt udhëzimit. Paraprakisht, plotësimi dhe përcaktimi i nivelit të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, është përgjegjësi e institucioneve të linjës. *Manuali për Plotësimin e Tabelave dhe Deklaratës së Përputhshmërisë dhe Udhëzime Praktike për Përafrimin e Legjislacionit të Republikës së Kosovës me Legjislacionin e Bashkimit Evropian*, përmbajnë udhëzime praktike për këtë proces.⁸


⁸ E qasshme përmes: <http://mei-ks.net/sq/dokumente-udhzuere-mbi-procesin-e-prafrimit-ligjor>

9. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për **Opinion Ligjor** për Përputhshmërinë e “*Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti*”, konstaton se fushëveprimi i këtij Ligji përfshinë parime të *acquis* së BE-së në fushën e skemave pensionale.

Me respekt,

Labinote Kashtanjeva

Pën: 

Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Çështje Ligjore të BE-së

Divizioni për të Drejtën e BE-së

Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit